



Република Македонија

Агенција за супервизија на капитално финансирано пензиско осигурување

**PROGRAMI VJETOR I PUNËS
I AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË FINANCIMIT
KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL I VITIT 2019**

Shkup, nëntor 2018

PËRMBAJTJA

I.	AKTIVITETET E AGJENCISË	3
1.	Çështjet administrative - ligjore.....	3
1.1	Aktet ligjore.....	3
1.2	Aktivitetet lidhur me marrëdhëniet e punës	3
1.3	Lëshimi i lejeve për dokumentet e parashtruara nga shoqëritë pensionale	4
2.	Kontrolli I shoqërive pensionale	4
2.1	Kontrolli jashtë terrenit.....	4
2.2	Kontrolli në terren.....	5
2.3	Aktivitetet e Komitetit të vlerësimit të rreziqeve	6
3.	Aktivitete që kanë të bëjnë me anëtarët	7
3.1	Aktivitete që kanë të bëjnë me shqyrtimin e ankesave dhe vërejtjeve.....	7
3.2	Njoftimi i personave të shpërndarë	7
3.3	Transferimi i anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër dhe nga një fond pensional vullnetar në një tjetër.....	7
4.	Proceset afariste dhe pajisjet TI.....	8
4.1	Aktivitetet e zhvillimit të mëtejshëm të proceseve afariste të Agjencisë	8
4.2	Mirëmbajtja e zgjidhjeve softuerike për proceset afariste që kanë të bëjnë me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional.....	8
5.	Organizimi i provimit të agjentëve.....	9
5.1	Organizimi i provimit të agjentëve.....	9
5.2	Programi i provimit të agjentëve	9
5.3	Azhurnimi i bazës së pyetjeve lidhur me shembuj praktikë	9
6.	Analizat statistikore dhe përgatitja e raporteve dhe planeve	10
6.1	Analizat statistikore.....	10
6.2	Përgatitja e raporteve dhe analizave	10
6.3	Përgatitja e planeve	11
7.	Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja.....	11
7.1	Bashkëpunimi me institucionet vendase	11
7.2	Bashkëpunimi me institucionet e huaja.....	11
8.	Kuadrot dhe trajnimet	12
8.1	Trajnime profesionale për punonjësit e Agjencisë	12
8.2	Shfrytëzimi i projekteve të misionit konsulent, me ndihmën e programit TAIEX i Komisionit Evropian	12

9.	Edukimi i opinionit	12
10.	Furnizimet publike dhe përgatitja e Planit financiar dhe Raporteve financiare	12
10.1	Realizimi i furnizimeve publike	12
10.2	Përgatitja e Planit financiar të Agjencisë	13
10.3	Përgatitja e Raporteve financiare të Agjencisë.....	13
11.	Implementimi i sistemit të administrimit të cilësisë dhe sistemit të administrimit të sigurisë së informatave.....	13
12.	Revizioni i brendshëm.....	13
II.	MJETET E PARAPARA PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË AGJENCISË	14
III.	DISPOZITA E FUNDIT	14

PROGRAMI VJETOR I PUNËS i agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional i vitit 2019

Me Programin vjetor të punës i Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional (në tekstin më poshtë: Agjencia) janë paraparë aktivitetet kryesore të cilat gjatë vitit 2019 të t'i realizojë Agjencia, në mbështetje të nenit 47 të Ligjit për financimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional.

I. AKTIVITETET E AGJENCISË

Agjencia, me programin e vetë të punës, gjatë vitit 2019, do t'i realizojë aktivitetet më poshtë:

1. Çështjet administrative - ligjore

1.1 Aktet ligjore

Gjatë vitit 2019 Agjencia do të propozojë ndryshimin e Ligjit për financimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional, Ligjit për financimin kapital të sigurimit pensional vullnetar dhe Ligjit për pagimin e pensioneve dhe pagesave lidhur me pensionet në financimin kapital të sigurimit pensional.

Agjencia do të vazhdojë përgatitjen e akteve të reja dhe ndryshimeve dhe plotësimeve të akteve nënligjore momentale që rrjedhin nga ligjet e fushës së financimit kapital të sigurimit pensional.

Afati: Viti 2019

1.2 Aktivitetet lidhur me marrëdhëniet e punës

Agjencia do të përgatis planet dhe raportet e rregullta, siç janë: Plani vjetor i punësimit, Plani vjetor i trajnimit të punonjësve administrativë, Raporti vjetor i shqiptimit të masave lidhur me përgjegjësinë disiplinuese dhe materiale të punonjësve administrativë, Raporti gjashtëmujor dhe vjetor i realizimit të Planit vjetor të punësimit, Raporti gjashtëmujor dhe vjetor i realizimit të Planit të trajnimeve të punonjësve administrativë, të organizuara nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës (MSHIA), Raporti me rang listën e vlerësimeve vjetore të punonjësve administrativë dhe dokumente të tjera të fushës së marrëdhënieve të punës, varësisht nevojave të Agjencisë.

Afati: Viti 2019

Agjencia do të vazhdojë me përgatitjen e akteve të reja interne dhe ndryshimin dhe plotësimin e akteve interne momentale që kanë të bëjnë me Ligjin e marrëdhënieve të punës, Ligjin për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, Ligjin për punonjësit administrativë, Ligjin për punonjësit e Sektorit publik dhe ligje të tjera.

Afati: Në vazhdimësi gjatë vitit 2019

1.3 Lëshimi i lejeve për dokumentet e parashtruara nga shoqëritë pensionale

Agjencia do të vazhdojë me lëshimin e lejeve/pëlqimeve për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të parashtruara nga shoqëritë pensionale, si në vazhdim: zgjedhje të anëtarit të Bordit Drejtues ose Mbikëqyrës i shoqërisë, Statuti i Shoqërisë, Statuti i Fondit pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, kontratat me subjektet juridike që ofrojnë shërbime me letra me vlerë, kontrata me rojtarin e pasurisë dhe emërimi i drejtuesit ose një personi tjetër që propozohet të jetë përgjegjës për vendimet e investimit, administrimit të rreziqeve, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun, kontrollin e agjentëve dhe përlllogaritjen e tërheqjeve të programuara.

Afati: viti 2019, me kërkesë të shoqërive pensionale.

2. Kontrolli I shoqërive pensionale

Agjencia do të realizojë rregullisht funksionin e saj kryesor, me kombinimin e kontrollit jashtë terrenit dhe kontrollit në terren të shoqërive pensionale.

2.1 Kontrolli jashtë terrenit

Me qëllim detektimin e problemeve dhe pengimin e shfaqjes së problemeve të reja në punën e shoqërive pensionale, Agjencia do të bëjë kontroll jashtë terrenit, që nënkupton si më poshtë:

- Kontroll të anëtarësimit dhe transferimit në një fond pensional;
- Kontroll të të dhënave të Regjistrimit të anëtarëve;
- Kontroll të shpërndarjes së kontributeve në llogaritë individuale të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale;
- Kontroll të shumës së kapitalit themeltar, mjeteve të veta dhe shumës dhe mjeteve likuide të shoqërive pensionale;
- Kontroll të materialeve dhe aktiviteteve të marketingut të shoqërive pensionale;
- Kontroll të punës së agjentëve të shoqërive pensionale;

- Kontroll të tarifave që i arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe rojtarët e pasurisë;
- Kontroll të aktiviteteve investuese të shoqërive pensionale me përdorimin e mjeteve të fondeve pensionale;
- Kontroll të vlerësimit të mjeteve të fondeve pensionale;
- Kontroll të kontabilitetit dhe raporteve financiare të fondeve pensionale dhe shoqërive pensionale;
- Kontroll të raporteve të revizorit të brendshëm, përgjegjësit për administrimin e rreziqeve dhe aktuarit të autorizuar;
- Kontroll të transferimit të mjeteve midis fondeve pensionale dhe nga fondet pensionale;
- Kontroll të pagimit të pensioneve dhe tarifave të fondeve pensionale;
- Kontroll të transaksioneve me letra me vlerë të individëve që kanë akses tek informatat konfidenciale në shoqëritë pensionale dhe rojtarët e pasurisë;
- Kontroll të njoftimeve të rregullta drejtuar Agjencisë;
- Fillim të procedurave të shlyerjes së detyrimeve dhe dorëzim të kërkesave për fillimin e procedurave të kundërvajtjes dhe
- Kontroll të materialeve dhe aktiviteteve të fushës së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Afati: viti 2019 në vazhdimësi.

2.2 Kontrolli në terren

Kontrolli në terren do të zhvillohet në ambientet e shoqërisë pensionale dhe rojtarit të pasurisë dhe do të mbarojë në ambientet e Agjencisë, me analizë të dokumenteve të dorëzuara nga ana e shoqërisë dhe rojtarit të pasurisë dhe me intervista me ekipin drejtues dhe punonjësit e shoqërisë pensionale dhe rojtarit të pasurisë.

Me kontrollin e rregullt vjetor të shoqërive pensionale dhe fondeve që administrohen prej tyre do të përfshihet periudha midis dy kontrolleve, duke filluar nga periudha e mbarimit të kontrollit të fundit, deri në periudhën e realizimit të kontrollit të ri. Kontrolli do të bazohet në metodën e mbikëqyrjes, me vlerësimin e rrezikut dhe do të mbulojë fushat në vazhdim:

- Administrimin dhe mbikëqyrjen e shoqërisë;
- Rreziqet financiare;
- Rreziqet operative;
- Rreziqet lidhur me pagesat e shoqërisë;
- Rreziqet lidhur me të dhënat e anëtarëve;
- Rreziqet e pagimit të mjeteve dhe
- Rreziqet lidhur me kuptimin dhe vetëdijesimin e opinionit.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2019.

Gjatë realizimit të kontrollit në terren mbi funksionimin e shoqërive pensionale do të zhvillohet edhe kontroll në terren mbi funksionimin e rojtarëve të pasurisë së fondeve pensionale, për vitet 2018 dhe 2019. Kontrolli do të bazohet në metodën e mbikëqyrjes, me vlerësimin e rrezikut dhe do të mbulojë fushat në vazhdim:

- Përlllogaritje të mjeteve neto dhe njësisë së kontabilitetit të fondeve pensionale;
- Ruajtje dhe evidentim të mjeteve të fondeve pensionale;
- Respektim të kufizimeve në rastet e investimit të mjeteve të fondeve pensionale dhe harmonizimi i tyre me rregullativën ligjore dhe nënligjore.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2019.

Në kuadër të kontrolleve në terren do të zhvillohen edhe kontrole të bashkëpunëtorëve afarist të shoqërive pensionale, në aspektin e harmonizimit të tyre me rregullativën ligjore dhe nënligjore.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2019.

2.3 Aktivitetet e Komitetit të vlerësimit të rreziqeve

Si pjesë e vlerësimit të rregullt dhe shqyrtimit të rreziqeve në financimin kapital të sigurimit pensional, në kuadër të Agjencisë funksionon Komiteti i vlerësimit të rreziqeve, të cilin e përbëjnë anëtarët e brendshëm të Këshillit të ekspertëve, anëtarë të kolegjit të Agjencisë dhe anëtarë nga radhët e drejtuesve të departamenteve të kontrollit financiar dhe institucional. Komiteti merret me çështjet në vazhdim:

- Vlerësim dhe revizion të rreziqeve lidhur me financimin kapital të sigurimit pensional dhe konstatimin e ekzistimit të rreziqeve ose shfaqjen e mundshme të rreziqeve të reja;
- Shqyrtim të raporteve dhe procesverbaleve të miratuara lidhur me kontrollin e realizuar;
- Shqyrtim të zhvillimeve më të reja në fushën e financimit kapital të sigurimit pensional ose në tregjet financiare, që mund të ndikojnë në vlerësimin e rreziqeve;
- Shqyrtim të efektivitetit të strategjive të lehtësimit të rreziqeve dhe në bazë të rezultateve të fituara propozim të ndryshimeve të strategjisë dhe planit vjetor të Agjencisë.

Afati: viti 2019.

3. Aktivitete që kanë të bëjnë me anëtarët

3.1 Aktivitete që kanë të bëjnë me shqyrtimin e ankesave dhe vërejtjeve

Agjencia do të vazhdojë të shqyrtojë ankesat, vërejtjet dhe parashtrirat e tjera me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve të tanishëm dhe të ardhshëm të fondeve pensionale. Agjencia do të shqyrtojë edhe ankesat e të siguruarve, anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, agjentëve, shoqërive pensionale dhe personave të tjerë që mendojnë se atyre u janë shkelur të drejtat e financimit kapital të sigurimit pensional. Duke vepruar sipas ankesave, vërejtjeve dhe parashtrirave të tjera, Sektori i kontrollit institucional do të propozojë marrjen e masave dhe aktiviteteve konkrete. Sektori i kontrollit institucional do të zhvillojë procedura për realizimin e të drejtave të anëtarëve të fondeve pensionale dhe në përgjithësi për shkeljen e të drejtave dhe interesave të të siguruarve dhe anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

Afati: viti 2019.

3.2 Njoftimi i personave të shpërndarë

Agjencia do të njoftojë rregullisht të siguruarit e shpërndarë përkohësisht në fondet pensionale të detyrueshme për afatin ligjor prej tre muaj për të lidhur kontratë anëtarësimi me një nga dy shoqëritë që administrojnë me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

Afati: viti 2019.

3.3 Transferimi i anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër dhe nga një fond pensional vullnetar në një tjetër

Sipas Ligjit për financimin kapital të sigurimit pensional, Agjencia ka një rol kontrollimi në procesin e transferimit të anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër. Në këtë kontekst, Agjencia do të kontrollojë mënyrën në të cilën shoqëritë pensionale realizojnë transferimin e anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër. Agjencia do të zhvillojë aktivitete kontrollimi edhe lidhur me procedurën e transferimit të një anëtari nga një fond pensional vullnetar në një tjetër.

Afati: viti 2019.

4. Proceset afariste dhe pajisjet TI

4.1 Aktivitetet e zhvillimit të mëtejshëm të proceseve afariste të Agjencisë

Për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve afariste të Agjencisë gjatë vitit 2019, që kanë të bëjnë me funksionimin e shtyllës së dytë dhe të tretë pensionale (përditësim dhe zhvillim) do të realizohen aktivitetet më poshtë:

- Monitorim dhe përditësim të proceseve afariste të automatizuara dhe aplikacioneve softuerike që janë pjesë e kontrolleve jashtë terrenit të shoqërive pensionale;
- Përmirësim të proceseve pas konstatimit të problemeve në praktikë ose me kërkesë të institucioneve të involvuara;
- Analizë dhe përsosje të proceseve afariste dhe aplikacioneve softuerike, në mbështetje të ndryshimeve të ligjeve dhe akteve nënligjore;
- Identifikim të proceseve të reja afariste dhe kontrolle të reja në kuadër të Agjencisë, që kanë të bëjnë me implementimin e Sistemit të administrimit të sigurisë së informatave sipas Standardit ISO/IEC 27001:2013.
- Zhvillim të proceseve për supervizionin informatik, të bazuar në vlerësimin e rreziqeve.

Afati: viti 2019.

4.2 Mirëmbajtja e zgjidhjeve softuerike për proceset afariste që kanë të bëjnë me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional

Mirëmbajtje të zgjidhjeve softuerike për proceset afariste lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë, në bashkëpunim me një shtëpi softuerike dhe zhvillim të zgjidhjeve të reja softuerike në bazë të proceseve afariste që rrjedhin nga implementimi i sistemit të administrimit të sigurisë, sigurisë së administrimit të informatave në mbështetje të Standardit ISO/IEC 27001:2013 dhe Ligjit për pagimin e pensioneve dhe pagesave përkatëse në fushën e financimit kapital të sigurimit pensional dhe ndryshimeve të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Afati: viti 2019.

5. Organizimi i provimit të agjentëve

5.1 Organizimi i provimit të agjentëve

Në mbështetje të Ligjit për financimin kapital të sigurimit pensional dhe Rregullores për agjentët e shoqërive pensionale, Agjencia do të realizojë provimin e angazhimit në detyrën e agjentit, dy herë në vit do të lëshojë vërtetime për marrjen e provimit të agjentit dhe do të bëj regjistrimin e agjentëve në Regjistrin e agjentëve. Provimi do të jepet për të gjithë materien e fushës së financimit kapital të sigurimit pensional dhe pagimit të pensioneve të financimit kapital të sigurimit pensional. Sesionet e provimeve do të zhvillohen nëse shoqëritë pensionale kanë interes për paraqitjen e kandidatëve për marrjen e provimit, angazhimin në detyrën e agjentit dhe regjistrimin në Regjistrin e agjentëve. Provimin në aspektin teknik do ta realizojë një subjekt juridik, i regjistruar në Regjistrin Qendror, që do të zgjidhet nga ana e Agjencisë.

Në mbështetje të Ligjit për financimin kapital të sigurimit pensional Agjencia do të zhvillojë revizion të çdo provimi të mbajtur dhe për këtë qëllim do të përgatis raporte përkatëse.

Afati: tremujori i dytë dhe i katërt i vitit 2019.

5.2 Programi i provimit të agjentëve

Agjencia do të bëj përditësimin e Programit të marrjes së provimit të agjentëve të shoqërive pensionale, në mbështetje të ndryshimeve të akteve relevante ligjore dhe nënligjore.

Afati: viti 2019.

5.3 Azhurnimi i bazës së pyetjeve lidhur me shembuj praktikë

Agjencia do të bëj revizion dhe azhurnim të bazës së pyetjeve dhe bazës së shembujve praktikë, më saktësisht do të ndryshojë ose heq dhe zëvendësojë me pyetje të reja të paktën 30% të pyetjeve të bazës së pyetjeve dhe bazës së shembujve praktikë, të paktën dy herë në vit.

Afati: viti 2019.

6. Analizat statistikore dhe përgatitja e raporteve dhe planeve

6.1 Analizat statistikore

Agjencia do të përgatis analiza statistikore për financimin kapital të sigurimit pensional ose për funksionimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe do të bëj raportime statistikore dhe analitike, që nënkupton përgatitjen dhe publikimin në ueb faqen e Agjencisë të materialeve më poshtë:

- Buletine mujore,
- Raporte statistikore kuartale dhe
- Raport statistikor vjetor.

Afati: viti 2019.

6.2 Përgatitja e raporteve dhe analizave

Agjencia do të përgatis raporte dhe analiza për financimin kapital të sigurimit pensional, si më poshtë vijon:

- Raport për gjendjen e financimit kapital të sigurimit pensional në vitin 2018.

Afati: tremujori i dytë i vitit 2019.

- Hulumtime dhe analiza dhe raporte krahasuese për tema me rëndësi për financimin kapital të sigurimit pensional.

Afati: viti 2019.

- Raporte për ndjekjen e risive të fushës së financimit kapital të sigurimit pensional.

Afati: viti 2019.

- Raport për funksionimin e Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional në vitin 2018.

Afati: tremujori i parë i vitit 2019.

6.3 Përgatitja e planeve

Agjencia do të përgatis Program vjetor për punën e Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2020.

Afati: tremujori i katërt i vitit 2019.

7. Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja

7.1 Bashkëpunimi me institucionet vendase

Agjencia do të vazhdojë të zhvillojë rregullisht ose sipas nevojës bashkëpunimin me institucionet vendase me të cilat ajo ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi, për të siguruar mbikëqyrje efikase.

Gjithashtu, Agjencia do të vazhdojë të iniciojë nënshkrimin e kontratave të reja të bashkëpunimit.

Afati: viti 2019.

7.2 Bashkëpunimi me institucionet e huaja

Agjencia do të vazhdojë të zhvillojë rregullisht ose sipas nevojës bashkëpunimin me institucionet e huaja me të cilat ajo ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi, për të siguruar mbikëqyrje efikase.

Gjithashtu, Agjencia do të vazhdojë të iniciojë nënshkrimin e kontratave të reja të bashkëpunimit.

Agjencia do të vazhdojë të iniciojë takime me rregullatorët e fondeve pensionale të vendeve të tjera, me qëllim shkëmbimin e përvojave të fushës së sistemeve pensionale.

Afati: viti 2019.

Pjesëmarrje në takimet dhe konferencat e organizuara nga IOPS

Agjencia do të vazhdojë të marrë pjesë në takimet dhe konferencat e organizuara nga IOPS (Organizata ndërkombëtare e supervisorëve pensional) anëtare e të cilës është që në vitin 2007.

Afati: Gjatë periudhës së definuar në vitin 2019.

8. Kuadrot dhe trajnimet

8.1 Trajnime profesionale për punonjësit e Agjencisë

Punonjësit e Agjencisë do të vazhdojnë të ndjekin trajnime profesionale në fushën e TI, rregullativës, supervizionit të shoqërive të fondeve pensionale, tregjeve të kapitalit, financave dhe kontabilitetit, aktuarisë, ISMS, standardeve ISO etj.

Gjithashtu, çdo punonjës në vazhdimësi do të ndjek trajnime gjenerike të parapara me Programin vjetor të trajnimeve i Ministrisë së shoqërisë informatike dhe administratës (MSHIA) sipas planit individual të përsosjes profesionale.

Afati: viti 2019.

8.2 Shfrytëzimi i projekteve të misionit konsulent, me ndihmën e programit TAIEX i Komisionit Evropian

Agjencia do të vazhdojë të dërgojë kërkesa në Komisionin Evropian për shfrytëzimin e projekteve të misionit konsulent, me ndihmën e programit TAIEX.

Afati: viti 2019.

9. Edukimi i opinionit

Në mbështetje të detyrimeve ligjore, Agjencia në vitin 2019 do të vazhdojë komunikimin me opinionin, me qëllim promovimin e saj të vazhdueshëm në fushën e financimit kapital të sigurimit pensional.

Aktivitetet: intervista, pres konferenca, dita e vetëdijes pensionale – 15 shtatori, përgatitje të informatorëve kuartal E-MAPAS, edukim i opinionit, deklarata dhe njoftime drejtuar opinionit në mediat e shkruara dhe elektronike, monitorim të shpalljeve të mediave lidhur me MAPAS dhe përditësim i rregullt i ueb faqes së Agjencisë.

Afati: viti 2019.

10. Furnizimet publike dhe përgatitja e Planit financiar dhe Raporteve financiare

10.1 Realizimi i furnizimeve publike

Për nevojat e Agjencisë, Sektori i çështjeve financiare – administrative do të zhvillojë aktivitete për realizimin e furnizimeve publike, në bazë të Planit vjetor të

furnizimeve publike të miratuar paraprakisht, në mbështetje të Ligjit të furnizimeve publike.

Afati: në vazhdimësi gjatë vitit 2019.

10.2 Përgatitja e Planit financiar të Agjencisë

Spektori i çështjeve financiare – administrative do të përgatis Planin financiar të Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2020.

Afati: tremujori i katërt i vitit 2019.

10.3 Përgatitja e Raporteve financiare të Agjencisë

Spektori i çështjeve financiare – administrative do të përgatis raporte financiare për Agjencinë e mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2018.

Afati: viti 2019.

11. Implementimi i sistemit të administrimit të cilësisë dhe sistemit të administrimit të sigurisë së informatave

Në mbështetje të detyrimeve të sistemit të administrimit të cilësisë, Agjencia në vitin 2019 do të vazhdojë të sigurojë sistemin e administrimit të cilësisë dhe administrimit të dokumenteve që rrjedhin nga standardet ISO. Në vitin 2019 do të zhvillohen kontrole të brendshme të rregullta mbi sistemin e administrimit të cilësisë, sipas një plani të përgatitur paraprakisht për vitin 2019 dhe njëkohësisht do të zhvillohet kontroll i rregullt i jashtëm.

Afati: viti 2019.

12. Revizioni i brendshëm

Revizioni i brendshëm është një aktivitet i pavarur për një vlerësim objektiv dhe këshillim, i implementuar me qëllim që të jap kontribut për rritjen e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të subjektit.

Revizioni i brendshëm do të zhvillojë punët që kanë të bëjnë me planifikimin, organizimin dhe realizimin e revizioneve në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore dhe standardeve ndërkombëtare të revizionit të brendshëm. Gjithashtu, revizioni i brendshëm do të realizojë qëllimet e tij kryesore me ndihmën e vlerësimit sistematik dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e procesit të administrimit të rreziqeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe harmonizimit të funksionimit në bazë të rregullave në fuqi, akteve interne dhe procedurave të Agjencisë.

Afati: viti 2019.

II. MJETET E PARAPARA PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË AGJENCISË

Aktivitetet e Planit vjetor të funksionimit të Agjencisë është paraparë të financohen me të ardhurat të cilat Agjencia do t'i realizojë gjatë vitit 2019, në mbështetje të dispozitave për financimin e Agjencisë, të parapara me nenin 56 paragrafi (3) i Ligjit për financimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional. Të ardhurat dhe shpenzimet e vlerësuara të Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional janë prezantuar me Planin financiar vjetor të vitit 2019, me shtjellim të shumës së të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara.

III. DISPOZITA E FUNDIT

Ky program hyn në fuqi të nesërmen pas publikimit në dërrasën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Përgatiti/Kontrolloi: Ferdi Kasami

Kryetari i Këshillit të ekspertëve

Maksud Ali

Shtojca: Paraqitja tabelare e dinamikës së aktiviteteve punuese të Agjencisë së mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional për vitin 2019

PARAQITJA TABELARE E DINAMIKËS SË AKTIVITETEVE PUNUESE TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL PËR VITIN 2019													
Nr. rend.	Aktiviteti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Çështjet administrative - ligjore												
1.1	Akte ligjore	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
1.2	Aktivite lidhur me marrëdhëniet e punës	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
1.3	Lëshim lejesh për dokumentet e parashtruara nga shoqëritë pensionale	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
2	Kontrolli i shoqërive pensionale												
2.1	Kontroll jashtë terrenit	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
2.2	Kontroll terreni				√	√	√	√	√	√			
2.3	Komiteti për vlerësimin e rreziqeve	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

3	Aktivitetet lidhur me anëtarët												
3.1	Aktivitetet lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe vërejtjeve	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
3.2	Njoftimi i personave të shpërndarë	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
3.3	Transferimi i anëtarëve nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër dhe nga një fond pensional vullnetar në një tjetër	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
4	Proceset afariste dhe pajisjet TI												
4.1	Aktivitetet për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve afariste të Agjencisë	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
4.2	Mirëmbajtje të zgjidhjeve softuerike	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
5	Organizimi i provimit të agjentëve												

5.1	Organizim të provimit të agjentëve				√	√	√				√	√	√
5.2	Program për provimin e agjentëve	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
5.3	Përditësimi i bazës së pyetjeve për shembujt praktikë	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
6	Analizat statistikore dhe përgatitja e raporteve dhe planeve												
6.1	Analiza statistikore	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
6.2	Përgatitje të raporteve dhe analizave	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
6.3	Përgatitje të planeve										√	√	√
7	Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja												
7.1	Bashkëpunim me institucionet vendase	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
7.2	Bashkëpunim me institucionet e huaja	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

7.3	Pjesëmarrje në takime dhe konferenca	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
8	Kuadrot dhe trajnimet												
8.1	Ndjekje të trajnimeve profesionale për punonjësit	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
8.2	Shfrytëzimi i projekteve të misionit konsulent me ndihmën e Programit TAIEX	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
9	Edukimi i opinionit	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
10	Furnizimet publike dhe përgatitja e Planit financiar dhe Raporteve financiare												
10.1	Furnizime publike	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
10.2	Përgatitje të Planit financiar										√	√	√
10.3	Përgatitje të Raporteve financiare të Agjencisë	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
11	Implementim të sistemit të administrimit të cilësisë	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

12	Revizioni i brendshëm	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√
-----------	------------------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---